



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP. Anr. 33/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli - kryesues, Ramush Bardiqi dhe Hidajete Gashi Alaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Subjektit Politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me seli në Prizren, parashtruar kundër Subjektit Politik Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK), me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 24.12.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.33/2025, e datës 23.12.2025, parashtruar nga Subjektit Politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me seli në Prizren, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK), me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 28 Dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 23.12.2025 në PZAP-i, është parashtruar ankesë nga Subjekti Politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me seli në Prizren, në të cilën pretendohet se Subjekti Politik Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK), me seli në Prizren, në tubimin e mbajtur më datë 22.12.2025, i cili tubim ka qenë i lejuar nga KKZ, ka bërë shkelje të Kodit të Sjelljes së Subjekteve Politike, gjatë fushatës zgjedhore.

Më tej në ankesë pretendohet se në rrjetin social Facebook të Subjektit Politik LPRK, është publikuar një fotografi në të cilën vërehet se pjesëmarrës në atë tubim ishin edhe dy fëmijë me shpinë të kthyer.

Me këtë veprim Subjekti Politik LPRK, ka shkelur Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, LZP dhe Rregullën Zgjedhore 07/2024.

Si dëshmi në ankesës, ka bashkangjitur një fotografi.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik LPRK, thekson se pas analizimit të ankesës së parashtruar nga Albert Kinolli, përfaqësuesi i subjektit politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës dhe fotografisë që i janë kanë bashkangjitur kësaj anese si dhe duke u bazuar në dëshmitë vizuale (fotografitë e bashkangjitura këtu), hedhin poshtë këto pretendime si te pabazuara për arsyet si ne vijim: 1.Në të gjitha fotografitë e shkreputa gjatë aktivitetit, shihet qartë se të pranishmit rreth tryezës së takimit dhe në hapësirën ku po zhvillohej tubimi janë ekskluzivisht persona të moshës madhore. Nuk ka asnjë fëmijë që është pjese e organizimit

apo që ulet ne tryezën e subjektit politik. 2.Tubimi është mbajtur në një ambient të hapur (lokal), ku mund të këtë lëvizje të qytetareve të tjerë në prapavijë që nuk kanë lidhje me subjektin LPRK. Megjithatë, në fotografitë vërtetohet se në rrethin e pjesëmarrësve aktivë të LPRK-së, nuk ka pasur asnjë të mitur. 3.Fotografitë e bashkëngjitura nga ana jonë (të shkrepura nga kënde të ndryshme: ballote, anësore dhe te përgjithshme) dokumentojnë te gjithë pjesëmarrësit. Ne asnjë prej tyre nuk identifikohet prani e fëmijëve, çka vërteton se pretendimi i palës ankimuese është i pasaktë dhe ka për qëllim dëmtimin e imazhit të subjektit

LPRK deklaron me përgjegjësi se ka respektuar nenin 3 te Rregullores Zgjedhore dhe te gjitha dispozitat ligjore qe ndalojnë përfshirjen e fëmijëve në fushatë,

Kërkojnë nga PZAP-i, që bazuar në provat vizuale të cilat kanë dorëzuar, të hedhë poshtë si të pabazuar ankesën nr.33/2025, pasi qe nuk ka asnjë fakt që vërteton praninë e fëmijëve në këtë tubim.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi pretendimet ankimore si dhe përgjigjen në ankese, gjeti se:

- **Ankesa është e pa bazuar**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se subjekti politik LPRK nuk ka bere shkelje të nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores NR.07/2024, i cili përcakton se*Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore, nuk mund të behet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve.* Mbi bazën e provave me saktësisht fotografinë e paraqitur nuk mund të vërtetohet se fëmijët kanë qenë të pranishëm në tubim zgjedhor. Në fotografinë e ofruar si provë, nuk mund të vërtetohet se pjesëmarrësit në tubimin zgjedhor të Subjektit Politik LPRK, të cilët janë fotografuar me shpinë të kthyer të jenë të mitur/fëmijë. Në anën tjetër neni 117 par. 3 LZP, kur vendos për ankesat PZAP-i, bazohet në prova të qarta dhe bindëse. Prandaj nuk qëndrojnë pretendimet e theksuara në ankese.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga prova e ofruar si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, pasi që ankesa e parashtruesit ka qenë sipërfaqësore dhe jo e konkretizuar me prova, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 te LZP-së, nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores NR.07/2024, për Fushatën Zgjedhore, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.33/2025 më datën 24.12.2025

Kryesues i Panelit,
Kujtim Pasull



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykata Supreme të Kosovë, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.